



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 656/1 Prot.

Tiranë, më 3.7.2023

**VENDIM**

**Nr. 45, datë 3. 7. 2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË  
KOMISIONERIT Nr. 59, Datë 28.4.2022.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 59, datë 28.4.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. 12004 prot., datë 5.7.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit doganor \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është paraqitur një informacion prej nëpunësit \*\*\*\*\* me nr. 224 prot., datë 11.3.2022, nëpërmjet të cilit pretendohet se, transferimi i tij i përkohshëm në pozicionin “Doganier”, në Sektorin Doganor Porto Romano, Dega Doganore Durrës, ka përfunduar, por nga ana e strukturave përgjegjëse nuk është ndërmarrë asnjë veprim për rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 59, datë 28.4.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. 12004 prot., datë 5.7.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit doganor \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.

Nëpërmjet shkresës nr. 472 prot., datë 23.5.2022, me lëndë: “Kërkohet informacion mbi zbatimin e vendimeve paralajmëruese të Komisionerit”, institucionit i është kërkuar informacion në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi.

Në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 10520/3 prot., datë 6.6.2022, administruar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 472/1 prot., datë 7.6.2022, ka informuar se në zbatim të Vendimit nr. 355, datë 26.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, është në proces ristrukturimi dhe përfundimi i procesit të ristrukturimit në zbatim të parashikimeve ligjore do të zgjidhë të gjitha rastet e referuara në vendimet e marra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ndodhur në këto rrethana, me qëllim që zbatimi i Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit të mos ecë paralelisht dhe të mos krijohet mbivendosje në kushtet kur institucioni është në proces ristrukturimi, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin nr. 97, datë 14.7.2022, ka vendosur pezullimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit të institucionit.

Vërej se, aktualisht ky proces ka përfunduar.

Mbështetur në detyrat e lëna në vendimin nr. 59, datë 28.4.2022, gjetjet e specifikuar në këtë vendim, si dhe pas verifikimit të dokumenteve përkatëse të prodhuara përmes korrespondencës së zhvilluar me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Departamentin e Administratës Publike, referuar shkresave nr. 419 prot., datë 24.4.2023, të Komisionerit, nr. 7079/1 prot., datë 4.5.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe nr. 2492/1 prot., datë 5.5.2023, të Departamentit të Administratës Publike ecuria e ekzekutimit të vendimit paralajmërues për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë:

Në pikën 1 të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Produkteve Energjitike, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (*Aposteriori*), pranë DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është tejkaluar afati maksimal 6-mujor i transferimit, parashikuar në pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.

Në vijim, në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 59, datë 28.4.2022, të Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 7079/1 prot., datë 4.5.2023, me lëndë: “*Kthim përgjigje*”, ka njoftuar mbi ekzekutimin e këtij vendimi, duke bashkëlidhur urdhrin nr. 3596, datë 27.2.2023, “*Për rikthim transferimin e nëpunësit për shkak të ristrukturimit*”, ku urdhërohet transferimi dhe emërimi i \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Produkteve Energjitike, Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (*Aposteriori*), në DPD.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit nr. 59, datë 28.4.2022, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nr. 12004 prot., datë 5.7.2021, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit doganor \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar detyrimet e vendimit nr. 59, datë 28.4.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe ngarkohet për njoftimin e nëpunësit \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**